



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 28/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërje Vjosa Gradinaj Mexhuani-Kryetare, Agon Ramadani Anëtar dhe Vedat Poterqoi-Antar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Cactus h.a" me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me licenca të Microsoft-it për IRK dhe Edukim" me numër prokurimi 214-22-13725-1-1-5, iniciuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) me 20.03.2023, mori:

V E N D I M

1. Hedhet poshtë si e palejuar ankesa e OE "Cactus sh.a" e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 30.01.2023, numër protokoli 28/2023, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me licenca të Microsoft-it për IRK dhe Edukim" me numër prokurimi 214-22-13725-1-1-5, sepse konsiderohet si palë pa interes juridik material, kurse mbetet në fuqi, njoftimi mbi vendimin e AK të datës 29.12.2022 për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit të cituar si më sipër.
2. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës për sigurim të ankesës sipas paragrafit 6, të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP. Kurse, ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, të paraqes kërkesë për kthim të mjeteve, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 30.11.2022, Ministria e Punëve të Brendshme, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si në hyrje të këtij Vendimi, përderisa afati i fundit për dorëzimin e ofertave ishte me 12.12.2022.

Me 29.12.2022, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar njoftimin mbi vendimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me licenca të Microsoft-it për IRK dhe Edukim” me numër të prokurimit 214-22-13725-1-1-5.

Me 30.12.2022, OE “Cactus sh.a” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim e cila është refuzuar si e pabazuar me Vendimin e AK të datës 04.01.2023.

Me 10.01.2023, OE “Cactus sh.a” ka parashtruar kundër Vendimit të cituar si më sipër ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 28/23.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 9, të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me nenin 105, të LPP.

Duke vepruar në kuptim të nenit 111, paragrafi 5 të LPP, OSHP ka formuar panelin shqyrtues në pajtim me nenin 21 të Rregullores së cituar, lidhur me nenin 106 të LPP, kurse me 11.01.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues me detyrë që i njëjti, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër, sikurse kërkohet me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar, lidhur me nenin 113 dhe 114 të LPP. I njëjti ka dorëzuar Raportin e ekspertizës me 30.01.2023, i cili përmban rekomandimet si në vijim:

- Të hedhet si e pa lejuar ankesa e OE “Cactus sh.a”
- Të mbetet në fuqi; Njoftimi mbi Vendimin e atakuar të AK për dhënie të kontratës;

Raporti i cituar si më sipër i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar, me ç ‘rast Ankuesi nuk është pajtuar me raportin përderisa AK është deklaruar se pajtohet. Në këtë rast, Paneli konstatoi se Raporti i ekspertizës përmban elementet qenësore për një raport të tillë, ndërsa palët janë të informuara lidhur me shkresat kësaj lënde (nga platforma e prokurimit elektronik) në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të kësaj Rregulloreje prandaj ka kushte për të vendosur përkitazi me ankesën.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli Shqyrtues, pasi konstatoi më parë se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, sikurse kërkohet kjo me nenin 11 të Rregullores për Punën e OSHP, analizoi në vijim të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se në shkresat e kësaj lënde ka prova të mjaftueshme për të vendosur lidhur me ankesën e cila i nënshtrohet shqyrtimit sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar, sipas së cilës paneli shqyrtues kryesisht vendos në seancë pa prezencën e palëve. Paneli paraprakisht konstatoi se, AK ka zbatuar procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, vlerë të madhe; lloji i kontratës furnizim; vlera e parashikuar e kontratës për tri vite 15,000,000.00 €;

Bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, konstatohet se Ankuesi ka pohuar se është bashkëpunëtor i kompanisë Softuer ONE, e cila gëzon të drejtën globale për furnizime të tilla prandaj ka shprehur interes (përmes komunikimi elektronik) të marr pjesë në këtë aktivitet të prokurimit, por meqë AK nuk e ka ftuar, pohon se është dëmtuar në këtë proces, sipas tij: jo transparent. Prandaj ka kërkuar që kjo procedurë të anulohet, të shpallet tenderi publik dhe të gjithë operatorët e autorizuar të kenë të drejtë të barabartë të konkurrimit, duke theksuar më tej se nga konkurrenca e lirë dhe transparenca nuk dëmtohet buxheti shtetëror.

Sipas Raportit të ekspertit shqyrtues konstatohet mes tjerash se AK ka aplikuar komunikim të drejtë për drejtë me prodhuesin “Microsoft” dhe ka vërtetuar faktin se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës, është vërtetë i autorizuar për shitjen e këtyre produkteve në territorin e Republikës së Kosovës, gjë që sipas ekspertit AK ka vepruar në pajtim me nenin 7 dhe 50 të LPP. Përderisa (po ashtu sipas ekspertit shqyrtues) AK po ashtu ka konstatuar se ankuesi nuk e ka dëshmuar me asnjë provë se është i autorizuar për shitjen e këtyre produkteve në territorin e Republikës së Kosovës andaj në këtë kontekst i njëjti nuk kualifikohet si “palë e interesuar”.

Krahas kësaj, në raportin e cituar konstatohet se eksperti ka kërkuar nga AK (me 20.01.2023) në cilësi të provës, komunikimet me “Microsoft”. Lidhur me këtë, AK i ka prezantuar komunikimet me përfaqësues të Microsoft¹ të cilët kanë shprehur shprehimisht se partnerët e Microsoft-it, gëzojnë statusin *Ofruesit e mëdhenj të zgjidhjeve* (LSP) dhe autorizohen nga Microsoft për të ofruar produkte dhe shërbime, sipas Marrëveshjes së Ndërmarrjes dhe Marrëveshjes së Abonimit të Ndërmarrjes me ç ‘rast Microsoft ka dy partnerë LSP të autorizuar për Republikën e Kosovës dhe atë: InfoSoft Systems sh.p.k dhe Komtrejd Distribucija DOOEL Shkup. Përveç kësaj, eksperti shqyrtues (pavarësisht nga AK) ka aplikuar korrespondencë me një nga drejtuesit kompetent sikurse deklarohet “përgjegjës për komunikimin komercial nga ana e Microsoft-it dhe person kontaktues për pyetje në lidhje me institucionet qeveritare në Republikën e Kosovës” i cili në shkresën e datë 26.01.2023 shprehimisht ka deklaruar se, cituar: “Në cilësinë time të ekzekutivit të llogarisë në Microsoft, përgjegjës për institucionet qeveritare në Republikën e Kosovës, konfirmoj se aktualisht, Microsoft Partnerët “InfoSoft Systems shpk” dhe “Komtrejd Distribucija Dooel Shkup” janë dy LSP (ofruesit e zgjidhjeve të licencimit) i autorizuar nga Microsoft për të ofruar produkte dhe shërbime sipas programeve të Marrëveshjes për Ndërmarrje të Microsoft dhe Marrëveshjes së Abonimit të Microsoft Enterprise në Republikën e Kosovës”.

Në kontekstin e rrethanave të përshkruara shkurtimisht si më sipër, eksperti shqyrtues ka krijuar bindjen e tij të pavarur se: a) Vetëm dy kompanitë e lartcekura janë të autorizuar që produktet e kërkuara në këtë prokurim, mund tu ofrohen Institucioneve të Republikës së Kosovës. b) Ankuesi nuk mund të jetë “palë e interesuar” në këtë procedurë, siç ka konstatuar dhe AK. Prandaj dhe ka rekomanduar që ankesa e OE ankues të hedhet si e palejuar. Në vijim të Raporti po ashtu theksohet se, cituar: “natyra e këtij prokurimi dhe niveli i qasjes që do ketë kompania e kontraktuar në këto sisteme/programe (sipas AK kompania do të ketë qasje në infrastrukturë kritike shtetërore),

¹ Emrat e të autorizuarve figurojnë në shkresat e lëndës

kujdesi/rreziku i mundshëm për siguri nacionale i shprehur nga AK është arsyeshëm për dërgimin e ftesës për ofertim vetëm kompanisë “Infosoft Systems”.

Pas analizimit të shkresave të kësaj lëndë dhe administrimit të gjitha provave në dispozicion, përfshirë mes tjerash veprimet dhe aktet e AK dhe mbështetur në raportin e ekspertit shqyrtues, Paneli shqyrtues ka konstatuar se AK ka përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, sikurse parashihet kjo shprehimisht (për raste me natyrë të tillë) me dispozitën e nenit 35 të LPP, sipas të cilit “Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës për të ushtruar aktivitetin e prokurimit vetëm në përputhje me këtë nen”. Ndërsa, përderisa ankuesi nuk e ka vërtetuar faktin se është i autorizuar për shitjen e këtyre produkteve, nënkuptohet se i njëjti nuk ka pranuar ftesë për ofertë, për tu përfshirë në *Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës* andaj objektivisht i njëjti nuk kualifikohet si “palë e interesuar” sikurse përkufizohet kjo me paragrafin 1.26, të nenit 4, të LPP.

Prandaj nga pikëpamja e këtij Paneli duke u mbështetur në raportin e ekspertit profesional shqyrtues, AK ka vepruar në pajtim me nenin 7 dhe 50 të LPP dhe për këtë arsye, nuk mund të pranohet fakti se AK ka dëmtuar buxhetin e shtetit dhe ka cenuar parimet e konkurrencën e lirë. Në kuptim të legjislacionit në fuqi, secili autoritet kontraktues ka të drejtë të veproj në kuptim të nenit 8 (planifikimi i prokurimit) dhe nenit 9 (përcaktimi i nevojave) duke i vepruar me tej, sikurse kërkohet me Rregullat për vlerësimin dhe klasifikimin e kontratave publike (Kreu IV, LPP), me Rregullat për specifikimet teknike dhe dosjen e tenderit (nenet 27–31), me rregullat mbi Llojet dhe zbatueshmërinë e procedurave të prokurimit (nenet 32-37), me Kërkesat e përshtatshmërisë dhe të kualifikimit (64-72) e tjera, të cilat e detyrojnë apriori secilin AK, në cilin do nivel, që të veproj me vigjilencë në kuptim të nenit 1, të LPP, sipas të cilit qëllimi parësor i LPP është të siguroj integritetin e prokurimit publik, kulturën institucionale dhe të profesionalizuar lidhur me shfrytëzimin e drejtë të fondeve publike. Nga ky kontekst e sidomos dhe për shkak të kërkesave specifike dhe sigurisë nacionale, Paneli konsideron se AK në këtë rast ka vepruar në harmoni me autorizimet e tij andaj kërkesa e Ankuesit për ta anuluar këtë aktivitet të prokurimit nuk ka bazë ligjore.

- *Përfundim* -

Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesa në këtë rast. Lidhur me këtë, duhet theksuar se në paragrafin 1.26, të nenit 4 (Përkufizimet), të LPP, përkufizohet shprehimisht statusi i palës së interesuar, sipas të cilit palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit, i zbatuar nga autoriteti kontraktues duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar. Paragrafi i cituar, do të thotë se Ankuesi duhet të dëshmojë interesin e tij material dhe faktin nëse është dëmtuar nga një shkelje e pretenduar. Meqë ankuesi nuk e ka vërtetuar statusin e të autorizuarit për shitjen e produkteve të cituara, nënkuptohet fakti se i njëjti, jo për qasjen e AK por objektivisht nuk ka pasur mundësi të

përfshihet si palë konkurrense në këtë aktivitet të prokurimit. Prandaj nga pikëpamja e këtij Paneli, ankesës në rastin konkret i mungon lënda ankimore, siç parashikohet me nenin 111, të LPP.

Në kontekstin shpjegimeve si më sipër, Paneli i vuri në zbatim po ashtu nenin 103, të LPP, sipas të cilit, “Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në *dispozicion të palëve të interesuara* siç është përkufizuar ky term (“palë e interesuar”) në nenin 4 të këtij ligji”. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga *palët e interesuara* duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë sipas nenit të cituar të LPP. Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin merititor të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të neni 111, të LPP.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit. Mbetet përgjegjësi e autoritetit kontraktues inicimi dhe zbatimi i kësaj procedure, po ashtu organeve kompetente si palë monitoruese e këtyre procedurave.

Prandaj Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetare e Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj Mexhuani



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

- AK – Ministria e Punëve të Brendshme
- OE- “Cactus sh.a”, me seli në Prishtinë
- Arkivës së OSHP-së;
- Për publikim në ueb- faqe të OSHP